# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
# FAKULTETI I BIZNESIT

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

## Programi i Studimit të Ciklit të Dytë
## Master i Shkencave "Menaxhim Biznesi"

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Juliana Osmani — Koordinatore e Programit të Studimit
2. Luftim Cania — Lektor i Departamentit të Menaxhimit
3. Oliana Sula — Lektor i Departamentit të Menaxhimit
4. Denada Liça — Lektor i Departamentit të Menaxhimit
5. Mario Gjoni — Lektor i Departamentit të Menaxhimit
6. Pamela Hasko — Përfaqësuese e Biznesit
7. Gisela Korbi — Studente e Programit
8. Spiro Paço — Koordinator Institucional për ASCAL
9. Marsida Dyrmishi — Specialiste DKSC

Korrik, 2023

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROÇES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

### Përshkrim përmbledhës: (200-400 fjalë)

Fakulteti i Biznesit hapi dyert për herë të parë në vitin akademik 2006-2007 dhe uli në auditorët e tij rreth 500 studentë nga pothuajse të gjitha trevat e vendit. Departamenti i Menaxhimit është një prej pesë njësive bazë të Fakultetit të Biznesit, i cili krahas programeve Bachelor dhe Master Profesional, kujdeset edhe për Programin e Studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Biznesi" (VKM Nr.1002, datë 30.09.2009).

Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është projektuar për të transmetuar tek studentët njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të menaxhuar suksesshëm organizatat në sektorin privat apo publik, si dhe për t'i aftësuar ata të identifikojnë fusha apo tema kërkimore-shkencore me synim ndihmesën e organizatave në arritjen e performancës së dëshiruar. Mjedisi dinamik, rivaliteti konkurues dhe rritja e shkallës së kompleksitetit të problemeve apo situatave me të cilat përballet një organizatë kërkon menaxherë të kualifikuar. Ky program studimi krijon një sërë mundësish për të bërë karrierë në fushën profesionale dhe akademike. Ai është dizenjuar në mënyrë të tillë që të mundësojë njohjen hap pas hapi të të gjitha aspekteve të menaxhimit të një organizate.

Qëllimi i programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është paisja e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi konceptet dhe teknikat e menaxhimit bashkëkohor. Përmes kombinimit të njohurive teorike me realitetin organizativ, programi u mundëson studentëve thellimin e njohurive me karakter kulturor, profesional dhe të specializuara, të nevojshme për menaxhimin e organizatave të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme; aftësimin për bërjen e analizave, vlerësimeve dhe diagnozave me natyrë strategjike; njohjen dhe përdorimin e instrumentave dhe metodologjisë së nevojshme për monitorimin e performancës si dhe zhvillimin e suksesin organizativ, stimulimin e qëndrimeve dhe sjelljeve që favorizojnë të qënit lider, inovacionin dhe iniciativën.

Programi Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" ofron njohuritë e duhura për studentët që dëshirojnë të punësohen në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në nivele të ndryshme hierarkike dhe nënndarje funksionale. Ndër të tjera, në përfundim të programit studenti mund të punësohet si: drejtues i nivelit të lartë në sektorin privat dhe publik, drejtues apo specialist në menaxhimin e operacioneve, drejtues apo specialist në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxher ose specialist në projekte, specialist në komunikim, në industrinë e turizmit, në sektorin bankar etj. Gjithashtu, përfundimi i këtij programi studimi u ofron studentëve mundësi për studime të mëtejshme në programe studimi më të thelluara si Doktoraturë dhe Master Ekzekutiv.

## PËRSHKRIMI I PROÇESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

### Përshkrim përmbledhës: (200-400 fjalë)

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e Ciklit të Dytë të Studimit Master Shkencor "Menaxhim Biznesi" është përgatitur nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të brendshëm (GVB), i ngritur me shkresën e Përgjegjësit të Departamentit të Menaxhimit, të datës 24/11/2021, Nr. Prot. 938, në përputhje me dispozitat ligjore të MAS, ASCAL dhe Statutin e UAMD-së. Përbërja e GVB është përcaktuar mbi bazën e disa kritereve që lidhen me aftësitë dhe kompetencat profesionale të tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, në integritetin dhe aftësitë e tyre për një analizë dhe vlerësim të paanshëm të dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm për kryerjen e proçesit të akreditimit. Në përbërjen e grupit është i përfshirë një student dhe një përfaqësues nga fusha e biznesit, në përputhje me kuadrin përkatës ligjor.

GVB për realizimin e proçesit të vlerësimit të këtij programi studimi është bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, udhëzimet dhe manuale të ASCAL-it, Statutin dhe Vendimet e Senatit Akademik të UAMD-së.

GVB në mbledhjen e informacionit, përpunimin e tij dhe hartimin e RVB, ka operuar duke ndarë ndërmjet anëtarëve të grupit të punës detyrat dhe përgjegjësitë, duke synuar arritjen e përfundimeve objektive e reale në funksion të vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi.

Njëherazi, GVB ka bashkërenduar dhe konsultuar proçesin në mënyrë të vazhdueshme me Koordinatorin Institucional të IAL-së. Po ashtu, GVB është trajnuar nga ekspertët e ASCAL-it për hartimin e raportit dhe gjenerimin e evidencave.

GVB ka mbledhur dhe analizuar të dhëna dhe informacione të nevojshme në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti, për të realizuar proçesin e vlerësimit të programit të studimit, të cilat në mënyrë përshkruese janë pasqyruar sipas rubrikave të fushave të përcaktuara në RVB dhe të dhënat mbështetëse, dokumentacioni bazë, të kërkuara për proçesin e akreditimit të programit të studimit janë pasqyruar në formë evidencash bashkëlidhur, referuar modelit të hartuar nga ASCAL në përputhje me kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë në IAL-të. RVB është i strukturuar në gjashtë fusha, me standardet dhe kriteret përkatëse, mbi bazën e të cilave, referuar dhe në dokumentacionin mbështetës faktik, është bërë vlerësimi i përmbushjes të standardeve të cilësisë nga programi i ofruar.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Menaxhim Biznesi"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Bazuar në Ligji i Arsimit të Lartë Nr.80, 2015 (Neni 1; Neni 5, pika ç; Neni 18, pika 3, 4; Neni 93, pika 1, 2; Neni 95, pika 2; Neni 107, shkronja c) [1] dhe Statuti i UAMD (Neni 3; Neni 4; Neni 7, pika 2; Neni 82, pika 1, 2; Neni 84, pika 2; Neni 94, shkronja c) [2], Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe njësitë kryesore të tij ofrojnë programe studimi në funksion të respektimit dhe promovimit të interesave kombëtare. Plotësimi i kërkesave dhe nevojave të shoqërisë në kushtet e një dinamizmi gjithnjë në rritje mbetet prioritar në ofrimin e programeve të studimit.<br>Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" synon përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesve në fushën e menaxhimit, të aftë të menaxhojnë suksesshëm organizatat në sektorin privat dhe atë publik, duke kontribuar njëkohësisht edhe në zhvillimin e shoqërisë, në respektim të interesave kombëtare[3, 4, 5].<br>Përpos sa cituar më sipër, bazuar edhe në Kodin e Etikës (Neni 4) [6], në hierarkinë e vlerave të UAMD-së, Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit të Menaxhimit qëndrojnë integriteti, ndershmëria, mirësjellja, vullneti i mirë, përgjegjshmëria etj. Duke e vënë theksin tek dimensioni njerëzor, programet e studimit të ofruara synojnë nxitjen e të mirës kombëtare. Si i tillë, programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" mbështetet në përvojën akademike dhe kulturore, i përgjigjet kërkesave të kohës dhe perspektivës së zhvillimit të vendit dhe synon ruajtjen dhe promovimin e vazhdueshëm të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me misionin dhe qëllimet që UAMD dhe njësitë përbërëse të tij kanë në ofrimin e një edukimi akademik dhe profesional përmes angazhimit të vazhdueshëm për arritjen e standardeve më të larta bashkëkohore, kombëtare dhe ndërkombëtare, në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, me qëllim formimin e shkencëtarëve të |

[1] Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015)
[2] Evidenca_Nr. 1_(Statuti i UAMD)
[3] Evidenca_Nr.54_(Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, VKM nr.710, Datë 1.12.2017)
[4] Evidenca_Nr.54.1_(Draft-Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030)
[5] Evidenca_Nr.91_(Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, VKM Nr. 621, Datë 22.10.2021)
[6] Evidenca_Nr.16_(Kodi i Etikës në UAMD)

| | |
|---|---|
| | rinj, të aftë të ndikojnë në zhvillimin e vendit, bazuar në Statutin e UAMD (Neni 3 dhe Neni 4)[7] si dhe Planin e zhvillimit strategjik të UAMD[8, 9].<br>Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" synon të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë njohuri, aftësi dhe kompetenca, teorike dhe praktike, me qëllim formimin e specialistëve të lartë në fushën e menaxhimit të biznesit, duke reflektuar dhe plotësuar nevojat që ka mjedisi akademik dhe profesional për njohuri të integruara dhe gjithëpërfshirëse në këtë fushë. Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik tek studentët, në aftësinë për të menduar dhe vepruar njëkohësisht si dhe për të gjykuar situatat specifike me të cilat po përballen organizatat[10, 11, 12, 13]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit. | Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznes" bazohet në strategjinë për zhvillim të UAMD[14, 15], Fakultetit të Biznesit[16, 17] dhe Departamentit të Menaxhimit [18, 19]. Referuar strategjive të zhvillimit në të tre nivelet, ky program studimi ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit.<br>Gjithashtu, ky program studimi ofrohet duke reflektuar dhe zbatuar Statutin e UAMD[20], Rregulloren e UAMD[21] si dhe Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[22], në respektim të plotë edhe të prioriteteve strategjike për zhvillimin e vendit.<br>Programi i studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi është projektuar për të transmetuar tek studentët njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi konceptet dhe teknikat e menaxhimit bashkëkohor. Përpos sa cituar më sipër, emërtimi, struktura dhe përmbajtja e tij reflektojnë plotësisht edhe fushat dhe drejtimet akademike të Departamentit të Menaxhimit[23]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit | Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit tregojnë vëmendje dhe angazhim ndaj interesave dhe prioriteteve strategjike kombëtare[24, 25, 26, 27, 28, 29]. Në kushtet e një mjedisi gjithnjë e më shumë dinamik, programet e studimit të ofruara përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme për të reflektuar ndryshimet e nevojshme. |

[7] Evidenca_Nr. 1_(Statuti i UAMD)
[8] Evidenca_Nr.2_( Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025)
[9] Evidenca_Nr.2.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020)
[10] Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025)
[11] Evidenca_Nr.3.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020)
[12] Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025)
[13] Evidenca_Nr.4.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2017-2021)
[14] Evidenca_Nr.2_( Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025)
[15] Evidenca_Nr.2.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020)
[16] Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025)
[17] Evidenca_Nr.3.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020)
[18] Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025)
[19] Evidenca_Nr.4.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2017-2021)
[20] Evidenca_Nr. 1_(Statuti i UAMD)
[21] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)
[22] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[23] Evidenca_Nr.99_(Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit)
[24] Evidenca_Nr.2_( Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025)
[25] Evidenca_Nr.2.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020)
[26] Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025)
[27] Evidenca_Nr.3.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020)
[28] Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025)
[29] Evidenca_Nr.4.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2017-2021)

| | |
|---|---|
| mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesat kombëtarë dhe trendet globale të zhvillimit, pasi reflekton në mënyrë të vazhdueshme përmirësime në planin mësimor dhe planet lëndore. Organizimi dhe përmbajtja e këtij programi studimi vjen si pjesë integrale e një vijueshmërie të planeve strategjike në të tre nivelet (Universitet, Fakultet, Departament), të cilat janë në vetvete reflektim i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim[30, 31], Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin[32, 33] si dhe Strategjisë Kombëtare për Arsimin[34]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit, pranë Fakultetit të Biznesit që prej vitit akademik 2009-2010. Njësia kryesore dhe ajo bazë dëshmojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi, duke mundësuar në këtë mënyrë përmbushjen e objektivave të tij[35, 36, 37, 38, 39]. Stafi i angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi gëzon një përvojë akademike, profesionale dhe kërkimore-shkencore, e cila është shfrytëzuar më së miri për realizimin dhe mbarëvajtjen e këtij programi[40, 41]. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, Fakultetit të Biznesit, dhe njësisë bazë, Departamentit të |

30 Evidenca_Nr.55_(Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, VKM Nr.348, Datë 11.05.2016)
31 Evidenca_Nr.55.1_(Draft-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030)
32 Evidenca_Nr.54_(Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, VKM nr. 710, Datë 1.12.2017)
33 Evidenca_Nr.54.1_(Draft-Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030)
34 Evidenca_Nr.91_(Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, VKM Nr. 621, Datë 22.10.2021)
35 Evidenca_Nr.69_(Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Menaxhimit dhe në Fakultetin e Biznesit)
36 Evidenca_Nr.65_(Të Dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MSH Menaxhim Biznes)
37 Evidenca_Nr.32_(CV e Stafit Akademik në MSH Menaxhim Biznesi)
38 Evidenca_Nr.33_(CV e Stafit Ndihmës Akademik në MSH Menaxhim Biznesi)
39 Evidenca_Nr.104_(Orari Master Shkencor MB 2018-2023 + CV Stafi Akademik)
40 Evidenca_Nr.43_(Fushat e Studimit për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit)
41 Evidenca_Nr.52_(Të Dhënat për Aktivitetet për Kualifikimin dhe Kërkimin Shkencor për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Menaxhimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane[42, 43, 44, 45]. | | | |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit i cili administron këtë program, referuar Vendimit për fushat kërkimore-shkencore të Departamentit të Menaxhimit[46] si dhe Rregullores për programin e studimit (Neni 2 dhe Neni 6)[47]. Hartimi dhe ofrimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit, sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e europiane[48, 49].<br>Departamenti i Menaxhimit nuk ofron programe studimi ndërdisiplinore. | | | |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master Shkencor" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit nuk ofrojnë programe studimi "Master Shkencor" jashtë profilit të tyre. | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit u ofrojnë studentëve të diplomuar mundësi për trajnime profesionale të mëtejshme në institucionet apo kompanitë me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi[50, 51]. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit organizon çdo vit edhe Panairin e Punës, ku krahas mundësive për punësim institucionet/kompanitë pjesëmarrëse ofrojnë mundësi për internshipe[52, 53]. Në funksion të sa më sipër, bazuar në Rregulloren e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike (Neni 14, Neni 15, Neni 16)[54], Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit bashkëpunojnë edhe në nivel institucioni me Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

[42] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[43] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[44] Evidenca_Nr.92_(Kodifikimi i Programeve në UAMD)
[45] Evidenca_Nr.99_(Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit)
[46] Evidenca_Nr.99_(Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit)
[47] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[48] Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015)
[49] Evidenca_Nr.92_(Kodifikimi i Programeve në UAMD)
[50] Evidenca_Nr.45_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit)
[51] Evidenca_Nr.45.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit)
[52] Evidenca_Nr.78_(Panairi i Punës)
[53] Evidenca_Nr.78.1_(Pyetësori Panairi i Punës 2022)
[54] Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)

| Standardi I.3<br>**Instituconi i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| Kriteret | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës ka marrëdhënie të ngushta mes strukturave akademike dhe administrative, të karakterizuara nga fryma e bashkëpunimit, ku detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave dhe personelit janë të specifikuara. Këto marrëdhënie rregullohen në Statutin e UAMD[55], Rregulloren e UAMD[56], Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[57] dhe Rregulloren e NJBSC[58]. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit[59] janë të përcaktuara qartë roli dhe detyrat e përgjegjësit të njësisë bazë (Neni 10 dhe 11), të përgjegjësit të grupit mësimor dhe kërkimor-shkencor (Neni 14), të koordinatorit të programit (Neni 15), të stafit akademik (Neni 16, 17, 18 dhe 19) etj.<br>Gjithashtu, Departamenti i Menaxhimit për mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit mësimor në Master Shkencor "Menaxhim Biznesi" ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda Fakultetit me departamentet e tjera për të mundësuar realizimin efektiv të objektivave që ka ky program studimi. Realizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qënë i nevojshëm për mbulimin e lëndëve që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi dhe që zhvillohen nga lektorë jashtë departamentit. Analiza e punës së tyre reflektohet në rezultatet e nxjerra nga analiza e ecurisë së programit të studimit dhe vlerësimi i arritjes së objektivave të tij[60]. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Në nivel Institucioni është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Ashtu sikurse, specifikohet edhe në Nenin 5, pika 6, dhe Nenin 9 të Rregullores së saj[61], një ndër objektivat strategjikë të kësaj Drejtorie është zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar.<br>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me njësi homologe vendase dhe të huaja, kompani biznesi private dhe institucione publike, organizata jofitimprurëse etj. Këto marrëveshje bashkëpunimi kanë për qëllim të mundësojnë përmbushjen e objektivave formuese të programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi"[62, 63, 64, 65]. |

[55] Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD)
[56] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)
[57] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[58] Evidenca_Nr.10_(Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë)
[59] Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit)
[60] Evidenca_Nr.19_(Analiza për Programin e Studimit Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[61] Evidenca_Nr.105_(Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë)
[62] Evidenca_Nr.45.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së)
[63] Evidenca_Nr.45_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit)
[64] Evidenca_Nr.45.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit)
[65] Evidenca_Nr.80_(Erasmus-Interinstitutional Agreements for mobility for learners and staff)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për t'u mundësuar studentëve realizimin e praktikave profesionale në fushën përkatëse të studimit[66, 67, 68]. Bashkëpunimi me institucione apo biznese vendase ose të huaja përbën një ndër fushat strategjike të zhvillimit të Departamentit të Menaxhimit[69, 70].<br>Përmes vendosjes së marrëdhënieve formale mundësohet realizimi dhe mbikqyrja e praktikave profesionale. Për secilin prej studentëve, ecuria e praktikës monitorohet nga pedagogu udhëheqës dhe personi mbikqyrës në institucionin/kompaninë ku zhvillohet praktika[71, 72]. Gjithashtu, marrëveshjet e lidhura ndihmojnë edhe në realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve[73]. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Departamenti i Menaxhimit në prezantimin e analizës vjetore të punës diskuton edhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit që ofron[74]. Në kuadër të bashkëpunimeve në të tre nivelet (Universitet, Fakultet, Departament) janë realizuar shkëmbime të stafit dhe të studentëve. Gjithashtu, janë realizuar aktivitete të tjera si leksione të hapura, vizita mësimore, raste studimore në auditor etj, duke ndihmuar në përmbushjen e objektivave formuese dhe të të nxënit të programit të studimit.<br>Departamenti i Menaxhimit është i ndërgjegjshëm për rëndësinë e analizave specifike të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe nisi ta realizojë këtë në vitin 2019[75]. Ngjarjet e viteve të fundit (tërmeti dhe pandemia) penguan shtrirjen më të gjerë të kësaj analize. Gjithësesi, departamenti gëzon eksperiencën e mjaftueshme dhe kontaktet e nevojshme për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të përfitimeve nga marrëveshjet. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

66 Evidenca_Nr.45.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së)
67 Evidenca_Nr.45_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit)
68 Evidenca_Nr.45.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit)
69 Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025)
70 Evidenca_Nr.4.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2017-2021)
71 Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit)
72 Evidenca_Nr.44_(Shembull praktike MSH në Menaxhim Biznesi)
73 Evidenca_Nr.45.3_(Lista e Marrëveshjeve për Mobilitete)
74 Evidenca_Nr.35_(Analiza vjetore të Departamentit të Menaxhimit)
75 Evidenca_Nr.45.4_(Analiza e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit)

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Bazuar në VKM, Nr.41, (datë 24.1.2018)[76], në nenet 58 dhe 63 të Statutit të UAMD[77], në Riorganizimin e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi 2018 (faqe 9-10, 21, 34-35)[78] dhe 2020 (faqe 4-7)[79], në Rregulloren e Fakultetit te Biznesit (neni 52)[80], në Rregulloren e Master Shkencor Menaxhim Biznesi (neni 8[81]) dhe në Urdhërin 138 për hapjen e programit të studimit të vitit 2009[82], programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisplinore dhe detyrime përmbyllëse[83,84] duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS)[85]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i Studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi[86], në Riorganizimin e Masterit Shkencor në Menaxhim Biznesi 2018[87] dhe 2020[88], ky program studimi synon të formojë studentë duke u bazuar në njohuri që ndërthurin disiplina humane me ato sasiore, përgatitjen e studentëve me njohuri të menaxhimit të organizatës në kontekstet e ndryshueshme dinamike. |

[76] Evidenca_Nr.101_(VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 - Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë)
[77] Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD)
[78] Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018)
[79] Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020)
[80] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[81] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[82] Evidenca_Nr.21_(Urdhëri për Hapjen e Programit të Studimit Viti 2009)
[83] Evidenca_Nr.24_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2020 e në vijim)
[84] Evidenca_Nr.24.1_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2018-2020)
[85] Evidenca_Nr.49_(Struktura e Programeve të Studimit në UAMD)
[86] Evidenca_Nr.5_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MSH Menaxhim Biznesi)
[87] Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018)
[88] Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Bazuar në VKM Nr.41, (datë 24.1.2018)[89], Statutin e UAMD (nenet 58 dhe 63)[90], në Rregulloren e Fakultetit te Biznesit (neni 52 dhe 66)[91], në Rregulloren e Master Shkencor Menaxhim Biznesi (neni 8, 15 dhe 18-19)[92], Riorganizimin e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi 2018[93, 94, 95] dhe 2020[96, 97, 98], dhe në Urdhërin 138 për hapjen e programit të studimit të vitit 2009[99], programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" citon ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Ndërtimi i programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është organizuar në mënyrë të tillë që çdo student realizon në përfundim të proçesit mësimor, praktikë mësimore[100, 101]. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | N/A |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | N/A |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë | N/A |

[89] Evidenca_Nr.101_(VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 - Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë)
[90] Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD)
[91] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[92] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[93] Evidenca_Nr.22.1_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2018)
[94] Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018)
[95] Evidenca_Nr.56.1_(Udhëzimi_nr._31_dt._29.12.2017_Hapje dhe Riorganizim Programesh)
[96] Evidenca_Nr.22_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2020)
[97] Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020)
[98] Evidenca_Nr.56_(Udhëzimi_nr._1_dt._14.01.2020_Hapje dhe Riorganizim Programesh)
[99] Evidenca_Nr.21_(Urdhëri për Hapjen e Programit të Studimit Viti 2009)
[100] Evidenca_Nr.24_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2020 e në vijim)
[101] Evidenca_Nr.24.1_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2018-2020)

| | |
|---|---|
| realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është i ngjashëm së paku 70 për qind me programe studimi të ofruar nga institucione ndërkombëtare[102, 103, 104]. Qëllimi kryesor është lehtësimi i transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar[105, 106]. Studentët mund të kryejnë mobilitet në kuadrin e projekteve dhe programeve ndërkombëtare[107]. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane[108]. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Europiane[109]. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | N/A |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e | Bazuar në Statutin e UAMD[110], në rregulloren e Fakultetit të Biznesit[111], të Departamentit të Menaxhimit[112], të programit të studimit[113] edhe në Udhëzimet |

[102] Evidenca_Nr.24_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2020 e në vijim)
[103] Evidenca_Nr.24.1_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2018-2020)
[104] Evidenca_Nr.102_(Kurrikula të ngjashme me MSH Menaxhim Biznesi)
[105] Evidenca_Nr.36.1_(Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2019-2021)
[106] Evidenca_Nr.36_(Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2022-2024)
[107] Evidenca_Nr.59_(Të dhëna mbi mobilitetet e studentëve në Fakultetin e Biznesit)
[108] Evidenca_Nr.92_(Kodifikimi i Programeve në UAMD)
[109] Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015)
[110] Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD)
[111] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[112] Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit)
[113] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)

| | |
|---|---|
| studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | 31[114] dhe Udhëzimin 1[115], Fakulteti i Biznesit si njësi kryesore dhe Departamenti i Menaxhimit si njësi bazë i përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit të studimit në tërësi duke u bazuar në kriteret specifike të tij. Stafi Akademik i Departamentit të Menaxhimit është i përbërë nga 16 anëtarë, ku 1 anëtar është me titullin Prof.Dr, 3 anëtarë janë më titullin Prof.Asoc.Dr., 10 anëtarë janë me Gradën Shkencore "Doktor Shkencash" dhe 2 anëtarë janë me MSc[116, 117, 118]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | N/A |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit (neni 9)[119], Departamenti i menaxhimit cakton një koordinator[120] për progamin e studimit që është përgjegjës në përgatitjen dhe koordinimin e materialeve pedagogjike, të praktikave profesionale dhe udhëzimeve për temën e diplomimit duke siguruar dhe mbikqyrjen e tyre, e cila është e specifikuar në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit, neni 15[121]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe | Departamenti Menaxhimit në Fakultetin e Biznesit në UAMD, është një njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon |

[114] Evidenca_Nr.56.1_(Udhëzimi_nr._31_dt._29.12.2017_Hapje dhe Riorganizim Programesh)
[115] Evidenca_Nr.56_(Udhëzimi_nr._1_dt._14.01.2020_Hapje dhe Riorganizim Programesh)
[116] Evidenca_Nr.66_(Të Dhëna Tabelore me Ngarkesën e Plotë Mësimore të Stafit Akademik, në të gjitha programet)
[117] Evidenca_Nr.67_(Të Dhëna Tabelore për Numrin e Programeve në Ciklin e I & II që ofron Departamenti i Menaxhimit)
[118] Evidenca_Nr.57_(Udhëzimi-nr.-29-dt-10.9.2018_Ngarkesa e Personelit Akademik)
[119] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[120] Evidenca_Nr.106_(Vendime për Koordinatorët e Programeve)
[121] Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit)

| | |
|---|---|
| përmbajtjen e programit të studimit. | disiplinat mësimore respektive[122, 123, 124, 125, 126]. Kjo njësi disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të studimit sipas ligjeve në fuqi, e cila është e cituar në nenet 35 dhe 38 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[127], në nenin 1 dhe 2 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit[128], në nenin 8 dhe nenet 14-18 të Rregullores së Programit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi[129]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | UAMD, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të këtyre programeve[130, 131, 132, 133, 134, 135]. Departmenti i Menaxhimit, për organizimin e veprimtarisë mësimore, këkimore – shkencore dhe administrative, mbështetet në Ligjin Nr.80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të", VKM nr.41, date 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"[136]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programet e studimit që ofron Fakulteti i Biznesit, janë të detajuara dhe informuese lidhur me të gjitha informacionet e nevojshme, përsa i përket kritereve të përgjithshme apo specifikë të pranimit, tranferimit dhe ekuivalentimit të studimeve[137, 138, 139]. Kjo është pasqyruar në nenet 37-39 dhe në nenin 47 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[140]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit | Programi i studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi i ofron studentëve informacione lidhur me programet lëndore, apo dhe orët jashtë auditorit dhe mënyrën e vlerësimit[141, 142, 143, 144]. Departamenti ka hartuar një plan mësimor i cili përmban përbërësit specifikë sipas kuadrit ligjor në fuqi. Kjo është e |

[122] Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020)
[123] Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018)
[124] Evidenca_Nr.21_(Urdhëri për Hapjen e Programit të Studimit Viti 2009)
[125] Evidenca_Nr.22.1_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2018)
[126] Evidenca_Nr.22_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2020)
[127] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[128] Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit)
[129] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[130] Evidenca_Nr.101_(VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 - Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë)
[131] Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020)
[132] Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018)
[133] Evidenca_Nr.21_(Urdhëri për Hapjen e Programit të Studimit Viti 2009)
[134] Evidenca_Nr.22.1_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2018)
[135] Evidenca_Nr.22_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2020)
[136] Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015)
[137] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)
[138] Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[139] Evidenca_Nr.50_(Praktika mbi Vendimet për Transferim Studimesh)
[140] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[141] Evidenca_Nr.26_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2019-2020)
[142] Evidenca_Nr.27_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2020-2021)
[143] Evidenca_Nr.28_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2021-2022)
[144] Evidenca_Nr.29_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2022-2023)

| | |
|---|---|
| brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | reflektuar në nenet 51, 52, 53 dhe 54 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[145, 146]. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Programet janë hartuar me qëllim që studentët të arrijnë njohuritë e nevojshme që u mundësojnë atyre një formim teoriko-profesional, në përshtatje të plotë me tregun e punës[147, 148, 149, 150, 151]. Departamenti i kushton një rëndësi të veçantë përditësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet përkatëse, ku një prej tyre është edhe miratimi i syllabuseve në çdo fillim viti akademik, duke iu përshtatur literaturave më të fundit[152, 153, 154, 155]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Përmbjatja e programeve të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë për studentët e UAMD, Fakulteti i Biznesit, thellim të njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me kërkesat e tregut të punës, duke i bërë ata më të aftë për këtë treg[156]. Programi Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" ofron njohuri të mira duke rritur mundësitë për karrierë profesionale të drejtuesve në sektorin privat dhe publik. Duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale bën të mundur punësimin e të diplomuarve në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme dhe industrive të ndryshme[157, 158, 159]. Kjo strukturë e programit të studimit është ndërtuar dhe shkon në pajtim me Ligjin për Arsimit e Lartë (80/2015) dhe Direktiva 2015/36 EC e Parlametit Europian dhe KE[160]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë | Kuadri formues i programit të studimit, lëndët/modulet, shpërndarja në semestra dhe vlerësimi në kredite i tyre, është hartuar në bazë të Kuadrit Kombëtar dhe Europian të kualifikimeve, të cilat bëjnë të mundur arritjen e rezultateve të |

[145] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[146] Evidenca_Nr.110_(Njoftime për studentët)
[147] Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020)
[148] Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018)
[149] Evidenca_Nr.21_(Urdhëri për Hapjen e Programit të Studimit Viti 2009)
[150] Evidenca_Nr.22.1_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2018)
[151] Evidenca_Nr.22_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2020)
[152] Evidenca_Nr.26_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2019-2020)
[153] Evidenca_Nr.27_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2020-2021)
[154] Evidenca_Nr.28_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2021-2022)
[155] Evidenca_Nr.29_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2022-2023)
[156] Evidenca_Nr.20_(Korrespondenca për Studimin e Tregut të Punës Përpara Hapjes së Programit të Studimit)
[157] Evidenca_Nr.41_(Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar)
[158] Evidenca_Nr.44_(Shembull praktike MSH në Menaxhim Biznesi)
[159] Evidenca_Nr.48_(Analiza e tregut të punës MSH Menaxhim Biznes)
[160] Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015)

| | |
|---|---|
| mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | pritëshme të të nxënit[161, 162, 163, 164, 165]. Lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentit të masterit njohuri dhe përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme. Lëndët karakterizuese janë lëndë që i ofrojnë përgatitje të thelluar në fushën e studimit në Menaxhim[166, 167]. |
379 Evidenca_Nr.36_(Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2022-2024)
380 Evidenca_Nr.63_(Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, Viti Akademik 2016-2017)
381 Evidenca_Nr.64_(Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, Viti Akademik 2017-2018)
382 Evidenca_Nr.64.1_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit V.A 2021-2022)
383 Evidenca_Nr.62_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2016-2023)
384 Evidenca_Nr.61_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencat Studentore)
385 Evidenca_Nr.63_(Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, Viti Akademik 2016-2017)
386 Evidenca_Nr.64.1_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit V.A 2021-2022)
387 Evidenca_Nr.64_(Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, Viti Akademik 2017-2018)
388 Evidenca_Nr.62_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2016-2023)
389 Evidenca_Nr.120_(Projektbuxheti i Departamentit të Menaxhimit)
390 Evidenca_Nr.124_(Studentët dhe Kërkimi Shkencor)

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.5<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | Studimet e programit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi përmbyllen me punim diplome[391]. Për të marrë pjesë në provimin e diplomës studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e tjera të kurrikulës. Ai mund të regjistrohet vetëm pasi shlyerja e këtyre detyrimeve konfirmohet nga sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit[392]. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Struktura përgjegjëse e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi është Departamenti i Menaxhimit, i cili sipas Rregullores i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit[393, 394, 395]. Sipas kritereve studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për t'u listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome. Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udhëheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe udhëheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Formati i paraqitjes së punimit të diplomës është përcaktuar në Rregulloren e Tezës së Diplomës Master në FB[396].<br>Përgjatë vitit akademik studentët mund të konsultohen me lektorët përkatës në lidhje me aspektet mësimore sipas orareve të konsultimit të ofruara nga lektorët[397]. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Studentët e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznes, realizojnë mbrojtjen e diplomës vetëm përmes tezës së diplomës. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e | Gjatë gjithë vitit akademik, personeli akademik me kohë të plotë ofron për studentët 5 orë konsultimi në javë për t'i orientuar ata për çdo paqartësi që mund të kenë në lidhje me lëndët përkatëse[398]. |

[391] Evidenca_Nr.12_(Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit)
[392] Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit)
[393] Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit)
[394] Evidenca_Nr.77_(Njoftime me e-mail Studentët e Masterit)
[395] Evidenca_Nr.76_(Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Biznesit)
[396] Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit)
[397] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[398] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)

| | |
|---|---|
| temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Teza e diplomës është punim individual i studentit. Ajo nuk mund të mbrohet përpara komisionit nëse më parë nuk është dhënë miratimi me shkrim i personelit akademik udhëheqës. Studenti duhet të dorëzojë në departament punimin përfundimtar në tre kopje së bashku me miratimin e personelit akademik udhëheqës të paktën 2 javë përpara datës së shpallur për mbrojtjen e temës[399].<br>Personeli akademik udhëheqës ruan kontakt të vazhdueshëm me studentin, e oriention dhe asiston atë gjatë zhvillimit të punimit dhe është përgjegjës për miratimin e këtij punimi[400]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Ambjentet e Fakultetit të Biznesit, laboratorët mësimorë-kërkimorë, biblioteka etj. janë në dispozicion të studentëve edhe jashtë orareve mësimore kur këta të fundit kërkojnë t'i përdorin këto ambjente për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve mësimore ose dhe projekteve kërkimore[401, 402, 403]. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Provimi ose tema e diplomës për programin Master Shkencor në Menaxhim Biznesi ka një peshë prej 13 kreditesh dhe vlerësohet me notë bazuar në pikët e përftuara nga studenti dhe me të njëjtën shkallë vlerësimi si lëndët e tjera të këtij programi, bazuar në Rregulloren e UAMD (Neni 68, pika 8)[404], Rregulloren e Diplomimeve në FB (Neni 11, pika 1)[405], Rregulloren e Mikrotezës (Neni 10, pika 1)[406]. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studentët e programit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi pajisen me diplomën e miratuar me Urdhër nr.160, datë 05 Qershor 2019, si dhe suplementin përkatës të diplomës[407]. Proçedurat e lëshimit të diplomës përcaktohen në Rregulloren e UAMD (Neni 76 dhe Neni 90)[408].<br><br>Suplementi i diplomës përmban të gjithë elementët e programit të studimit. Ky dokument ofrohet në shqip dhe në anglisht[409].<br><br>Në çdo kohë studentët dhe ish studentët e FB-së mund të kërkojnë pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Biznesit vërtetime të thjeshta dhe listë notash të programit të studimit që ndjekin ose kanë përfunduar. Me kërkesë të tyre ata mund të pajisen edhe me programin lëndor për çdo kurs që ata kanë zhvilluar[410].<br><br>Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | |

[399] Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit)
[400] Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit)
[401] Evidenca_Nr.51_(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit)
[402] Evidenca_Nr.117_(Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB)
[403] Evidenca_Nr.121_(Kalendari i Funksionimit të Bibliotekës në fundjavë)
[404] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)
[405] Evidenca_Nr.12_(Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit)
[406] Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit)
[407] Evidenca_Nr.31_(Urdhër Nr.160, Datë 05.06.2019 Regjistrimi i Formës së Diplomës në MSH Menaxhim Biznes)
[408] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)
[409] Evidenca_Nr.96_(Dosja e Programit Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
[410] Evidenca_Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit)

| | |
|---|---|
| | për studentin nëse kërkohen, siç specifikohet edhe në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore FB (Neni 27)[411]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | UAMD, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit kanë realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private, të cilat shfrytëzohen edhe për praktikën profesionale të studentëve të programeve master. Megjithatë lidhur me këtë vlen të theksohet se zgjedhja e institucionit/kompanisë për praktikën profesionale i lihet studentit dhe kur ai nuk mund ta gjejë atë, atëherë institucioni/fakulteti/departamenti përpiqet të shfrytëzojë për këtë qëllim marrëveshjet e lidhura[412, 413, 414]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Fakulteti i Biznesit nuk ka programe studimi ku të përfshihen praktika klinike. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (Neni 17)[415] dhe në Rregulloren e praktikës profesionale[416], kjo e fundit përfundon me hartimin e një raporti mbi eksperiencën e fituar dhe të një formulari ku vlerësohet ecuria e praktikës nga pedagogu udhëheqës[417]. Këto dokumenta paraqiten dhe dorëzohen nga studenti para komisionit, ditën e mbrojtjes së praktikës dhe ruhen në departament.<br>Mbrojtja e praktikës me sukses ekuivalentohet në kredite ECTS[418, 419]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

411 Evidenca_Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit)
412 Evidenca_Nr.45.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit)
413 Evidenca_Nr.45_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit)
414 Evidenca_Nr.45.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së)
415 Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi)
416 Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit)
417 Evidenca_Nr.44_(Shembull praktike MSH në Menaxhim Biznesi)
418 Evidenca_Nr.24.1_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2018-2020)
419 Evidenca_Nr.24_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2020 e në vijim)

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Personeli akademik efektiv dhe me kontratë si edhe personeli ndihmës akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit për t'u angazhuar në realizimin e veprimtarive, të moduleve dhe lëndëve të programit të studimit[420].<br>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit Master Shkencor Menaxhim Biznesi, i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij[421].<br>Personeli efektiv akademik dhe me kontratë zotëron tituj dhe grada në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Programi i studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznesi mbulohet nga Njësia Bazë, Departamenti i Menaxhimit. Në departamentin e Menaxhimit janë 16 lektorë efektivë ku 1 prej tyre zotëron titullin Prof. Dr, 3 prej tyre zotërojnë titullin Profesor i Asociuar, 10 prej tyre zotërojnë gradën Doktor. Fushat e studimit të anëtarëve të Departamentit janë në përputhje me modulet dhe lëndët e ofruara nga programi i studimit. Kjo pasqyrohet edhe në të dhënat për aktivitetet për kualifikimin shkencor në vitet e fundit si edhe në fushat e kërkimit shkencor të Departamentit[422, 423].<br>Gjithashtu, institucioni kontribuon në rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të stafit akademik[424]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Udhëzimi Nr.29 i datës 10.09.2018 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përcakton ngarkesën mësimore të personelit akademik efektiv në IAL në bazë të kategorive të ndryshme. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Master Shkencor "Menaxhim Biznesi" mbulon ngarkesën mësimore bazuar në kornizën ligjore në fuqi[425, 426]. |

[420] Evidenca_Nr.32_(CV e Stafit Akademik në MSH Menaxhim Biznesi)
[421] Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015)
[422] Evidenca_Nr.52_(Të Dhënat për Aktivitetet për Kualifikimin dhe Kërkimin Shkencor për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit)
[423] Evidenca_Nr.99_(Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit)
[424] Evidenca_Nr.100_(Trajnimi i stafit QEV)
[425] Evidenca_Nr.57_(Udhëzimi-nr.-29-dt-10.9.2018_Ngarkesa e Personelit Akademik)
[426] Evidenca_Nr.66_(Të Dhëna Tabelore me Ngarkesën e Plotë Mësimore të Stafit Akademik, në të gjitha programet)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Marrëdhënia e punësimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës rregullohet nëpërmjet kontratës së punësimit si edhe personeli akademik i angazhuar mbulohet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore[427, 428] Çdo muaj Drejtoria e Shërbimeve Financiare e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës i përcjell me e-mail raportimin e pagës personelit akademik ku janë të detajuara dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore[429]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | UAMD rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (Nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren e UAMD dhe Statutin e UAMD.<br>Në varësi të strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr.30, datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", Njësia Bazë përcakton kriteret që duhet të përmbushen nga aplikanti. Këto kritere i përcillen Drejtuesit të Njësisë Kryesore, i cili pasi i miraton ia përcjell Rektorit[430].<br>Mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga njësia bazë, shpallet konkurs i hapur "Për vendet të lira të punës për personel akademik me kohë të plotë" (ose të pjesshme) dhe kryhet publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjensisë së Prokurimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu, njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të UAMD[431].<br>E njëjta proçedurë rekrutimi ndiqet edhe në rastin e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Rregulloren e UAMD. Kërkesat për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme përcaktohen bazuar në nevojat e Njësisë Bazë sipas programeve përkatëse të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Personeli ndihmës akademik i Fakultetit të Biznesit është i përbërë nga 3 laborantë që ofrojnë suport për veprimaritë mësimore dhe në mjediset e tjera mësimore. Ky personel ka kualifikimin e duhur dhe i përshtatet nevojave dhe natyrës specifike të programit të studimit[432]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna | Çdo vit akademik personeli akademik plotëson formularët e vetvlerësimit ku pasqyrohet progresi shkencor dhe akademik mbi të cilin bëhet vlerësimi i performancës[433]. Njësia bazë dhe njësia kryesore hartojnë çdo vit analizën |

[427] Evidenca_Nr.73_(Model Kontrate Pune - UAMD)
[428] Evidenca_Nr.115.1 (Vërtetim për Kontributet e Sigurimit Shoqëror dhe Shëndetësor)
[429] Evidenca_Nr.115_(Raportimi mujor i pagës)
[430] Evidenca_Nr.107_(Politikat e BNJ, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen)
[431] Evidenca_Nr.107.1_(Proçedura për Rekrutimin e Stafit)
[432] Evidenca_Nr.33_(CV e Stafit Ndihmës Akademik në MSH Menaxhim Biznesi)
[433] Evidenca_Nr.40_(Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut)

| | |
|---|---|
| përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | vjetore në të cilën pasqyrohet progresi i personelit[434]. Gjithashtu "Baza e të dhënave të Kërkimit Shkencor" mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit të kërkimit shkencor duke mundësuar një vlerësim periodik dhe një rankim në kohë reale të tij. Ky rankim bëhet në nivel kombëtar (sipas fushave), përmes portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore", në platformën ACRIS (Sistemi shqiptar i informacionit të kërkimit shkencor) që administrohet nga AKKSHI. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit kanë marrëveshje me IAL dhe organizata publike dhe kompani biznesi. Studentët kanë në dispozicion Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike që ka nën varësi Sektorin e Komunikimit, Karrierës dhe të Alumni ku Neni 15 i rregullores së kësaj Drejtorie përcakton funksionimin e Sektorit të Komunikimit, Karrierës dhe Alumni dhe shërbimeve që ajo ofron për studentët në proçesin e praktikës dhe punësimit[435]. Në Rregulloren e Praktikës Mësimore përcaktohen strukturat përgjegjëse të praktikës mësimore në Nenin 3 të saj dhe në Nenin 4 proçesi i zhvillimit të praktikës mësimore[436]. Në Rregulloren e Tezës së Diplomës në Nenin 2 dhe Nenin 3 përcaktohet udhëheqësi dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të diplomës[437]. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimimi me IAL të tjera, përfaqësues biznesi dhe kompani të cilat lehtësojnë zhvillimin e praktikave mësimore dhe realizimin e punimeve të diplomës. Marrëveshje bashkëpunimi janë të lidhura edhe në nivel departamental[438, 439, 440]. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve/raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Neni 4 i Rregullores së Praktikës Mësimore përcakton proçesin e zhvillimit të praktikës mësimore për studentët e Masterit Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës[441]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[434] Evidenca_Nr.35_(Analiza vjetore të Departamentit të Menaxhimit)
[435] Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)
[436] Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit)
[437] Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit)
[438] Evidenca_Nr.45.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit)
[439] Evidenca_Nr.45.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së)
[440] Evidenca_Nr.45.3_(Lista e Marrëveshjeve për Mobilitete)
[441] Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit)

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | Vlerësimi i ekspertëve |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Proçesi mësimor zhvillohet në tre godina, një në Currila dhe dy në Kampusin Universitar, Spitallë duke krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.<br>Fakulteti i Biznesit e zhvillon proçesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr.2 të Kampusit Universitar, Spitallë. Në këtë godinë disponohen mjedise të mjaftueshme mësimore: 15 auditorë, 2 laboratorë, biblioteka dhe salla e konferencave, të cilat janë të dispozicion të proçesit të mësimdhënies dhe studimit për të garantuar veprimtarinë mësimore të programit të studimit[442]. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Mjediset mësimore dhe laboratorike në Fakultetin e Biznesit, që ndodhen në godinën Nr.2 të Kampusit Universitar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, janë të pajisuara me të gjitha pajisjet e nevojshme teknologjike dhe digjitale që janë të nevojshme për proçesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Të gjitha klasat janë të pajisura me tabela whiteboard dhe mundësi për videoprojektor të lëvizshëm të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore.<br>Zyrat e personelit akademik dhe administrativ që gjenden në këtë godinë janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kompjuter, printer, tavolinë pune, dollap etj). Laboratorët janë të përshtatshëm për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve[443]. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët e Fakultetit të Biznesit plotësojnë nevojat e studentëve të programit Master Shkencor Menaxhim Biznesi duke i ofruar pajisjet e duhura teknologjike dhe digjitale në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyra për studim dhe kërkim shkencor. Dy laboratorët që janë në funksion të Fakultetit të Biznesit kanë gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 m2. Laboratorët janë të pajisur me programe standarte, por edhe specifike si Financa 5, të cilat plotësojnë nevojat e studentëve për studim dhe kërkim shkencor[444]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Institucioni me kapacitetet që zotëron garanton, infrastrukturën e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave laboratorike. Së fundmi, në godinën e re të Fakultetit të Biznesit, në kampusin e ri universitar është ndërtuar laboratori i ri i pajisur me të gjitha kompjuterët dhe me të gjithë mjetet e duhura për studentët për të realizuar proçesin mësimor për lëndë specifike të profilit të tyre. Laboratori është bërë i mundur nga bashkëpunimi i Fakultetit të Biznesit me qendrën Crystal Center. Gjithashtu, në të gjithë kompjuterat e këtij laboratori do të |

442 Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura)
443 Evidenca_Nr.117_(Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB)
444 Evidenca_Nr.117_(Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB)

| | |
|---|---|
| | instalohet programi Financa 5, i cili duhet të njihet nga çdo ekonomist dhe menaxher i ardhshëm[445]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | N/A |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Në çdo fillim semestri studentët e programit të studimit MSH Menaxhim Biznes, njihen me literaturën bazë dhe ndihmëse të kërkuar për realizimin me sukses të proçesit mësimor, sikurse është parashikuar në syllabuset e lëndëve. Kjo literaturë është vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit nga personeli akademik duke garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Literatura bazë për çdo lëndë që ofrohet në këtë program studimi është në gjuhën shqipe dhe angleze[446, 447, 448, 449].<br>Mbështetur në Nenin 38 të Rregullores së Shërbimeve Akademike[450], Biblioteka Shkencore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës siguron literaturën bazë dhe ndihmëse nëpërmjet ofrimit të sallës me fond të hapur me literaturë referenciale, periodikë, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës, literaturë me burime elektronike të huaja. Literatura e vënë në dispozicionin e studentëve mbështet nevojat e tyre mësimore dhe të kërkimit shkencor. Biblioteka disponon gjithashtu edhe një fond të mbyllur. 80% e literaturës së |

445 Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura)
446 Evidenca_Nr.26_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2019-2020)
447 Evidenca_Nr.27_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2020-2021)
448 Evidenca_Nr.28_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2021-2022)
449 Evidenca_Nr.29_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2022-2023)
450 Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)

| | |
|---|---|
| | vënë në dispozicion është e 10 viteve të fundit dhe nga shtëpitë botuese të mirënjohura ndërkombëtarisht. Gjithashtu, studentët nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) kanë akses në platformën U-Albania. Literatura bazë është e mbledhur edhe në listën e titujve në Bibliotekë për programin e studimit[451, 452]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Njësia bazë raporton rregullisht nevojat për pasurimin e koleksioneve fizike dhe digjitale të bibliotekës me botimet e viteve të fundit të literaturës bazë dhe të rekomanduar të lëndëve të kurrikulës së programit të studimit. Përgjegjësi i njësisë bazë transmeton të dhënat përmbledhëse të mbledhura nga personeli akademik mbi literaturën bazë dhe të rekomanduar të lëndëve dhe moduleve të ndryshme. Që të garantohet cilësia e mësimdhënies, syllabuset e lëndëve përditësohen vazhdimisht me botime të viteve të fundit[453, 454]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | UAMD vë në dispozion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën mësimore e cila mundëson jo vetëm ambiente studimi, por edhe ambiente sociale, si edhe ambiente të cilat mund të shfrytëzohen nga studentë dhe kërkues shkencorë për promovimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndryshme hulumtuese, si edhe garanton ofrimin e shërbimeve për një akses të hapur. Sipas Nenit 32 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike, përdorues i bibliotekës është personi juridik ose fizik që paraqet një kërkesë me shkrim ose jo për të përfituar falas ose sipas tarifave të miraturara një shërbim që ofrohet nga Biblioteka e UAMD[455]. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Në Nenin 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike specifikohet që Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës" disponon sallat me fond të hapur dhe me fond të mbyllur. Salla me fond të hapur ofron literaturë referenciale, periodikun, literaturë print, literaturë prej burimeve elektronike të Bibliotekës, literaturë prej burimeve elektronike të huaja dhe akses në Internet. Ndërsa salla me fond të mbyllur ofron literaturë në gjuhë të huaj, revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale[456]. Institucioni vë në dispozicion gjithashtu edhe Listën e Paketave që përfshihen në U-LIBRARY dhe j-stor.org [457, 458]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës garanton akses të plotë pa pagesë në paketën U-LIBRARY për të gjithë studentët si dhe j-stor.org në të cilat ka një shumëllojshmëri literature për studentët e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Biznes. Në dispozicion të studentëve janë edhe sistemi KOHA dhe COBISS. Studentët kanë gjithashtu në dispozicion edhe një manual të përdorimit të Bibliotekës online[459, 460]. |

[451] Evidenca_Nr.51_(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit)
[452] Evidenca_Nr.71_(Digital Library - Universiteti Aleksandër Moisiu)
[453] Evidenca_Nr.51_(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit)
[454] Evidenca_Nr.93_(Proçedura për Pasurimin e Literaturës në Bibliotekë)
[455] Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)
[456] Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)
[457] Evidenca_Nr.70_(Marrëveshjet e Bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore)
[458] Evidenca_Nr.82_(Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme)
[459] Evidenca_Nr.81_(Manual Biblioteka Online)
[460] Evidenca_Nr.82_(Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme)

| | |
|---|---|
| | Sistemi KOHA është një databazë e krijuar nga biblioteka e UAMD-së dhe ndihmon përdoruesit të shkarkojnë libra, artikuj shkencor, disertacione etj, pa limit kohor përdorimi.<br>COBISS+ është krijuar për të gjithë përdoruesit: kërkuesit shkencorë, nxënësit, studentët, prindërit, profesorët, pensionistët etj, për të gjithë ata që kërkojnë informacione dhe materiale (edhe ato elektronike), të cilat janë në dispozicion në bibliotekat e Shqipërisë. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Salla me fond të hapur ofron të gjitha fasilitetet digjitale në formën hardware apo software për të lehtësuar veprimtarinë kërkuese dhe studimore të të gjithë studentëve të programit të studimit, e cituar kjo edhe në Nenin 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike[461]. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Oraret e shërbimit të Bibliotekës janë përshtatur me oraret e zhvillimit të proçesit mësimor. Biblioteka ka orare të përshtatshme me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. Për t'i ardhur në ndihmë studentëve, Biblioteka është e hapur edhe në fundjavë duke siguruar shërbim të pandërprerë për përdoruesit e saj[462]. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Njësia bazë, Deparamenti i Menaxhimit, përgjegjëse për programin e studimit MSH Menaxhim Biznes ndjek dhe raporton nevojat për fondin fizik dhe fondin online të programit të studimit në bashkëpunimin me bibliotekën në mënyrë që të përmbushen nevojat e studentëve të programit të studimit[463]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[461] Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)
[462] Evidenca_Nr.121_(Kalendari i Funksionimit të Bibliotekës në fundjavë)
[463] Evidenca_Nr.93_(Proçedura për Pasurimin e Literaturës në Bibliotekë)

| Standardi IV.4<br>**Institucioni i arsimit të lartë dispkonon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike (Neni 30)[464], sekretaria e Fakultetit të Biznesit, si edhe Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit disponjnë një sistem të menaxhimit të informacionit të studentëve në hyrje dhe në dalje. Pjesë e rëndësishme e sistemit të menaxhimit të informacionit në lidhje me studentët përbëhet nga Sekretaritë mësimore në çdo fakultet dhe sistemet elektronike. Funksionet e Sekretarisë mësimore për Fakultetin e Biznesit janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[465] dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore[466] .<br>Sekretaria mësimore administron të gjithë informacionin që lidhet me të dhëna të detajuara për studentët që regjistrohen, mbështetur në Nenin 27, pika 1 dhe 2, të Rregullores së Sekretarisë Mësimore. Ndjekja e informacioneve në lidhje me studentët bëhet që në momentin e regjistrimit në regjistrin bazë dhe në regjistrin e arritjeve akademike, sipas Neneve 76-80 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit, deri në momentin e diplomimit të tyre. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit ka në dispozicion të studentëve sistemin Pitagora në të cilën studentët aksesojnë informacione të ndryshme përgjatë kohës së studimit[467, 468]. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit, si edhe Struktura e Burimeve Njerëzore menaxhojnë dhe administrojnë dokumentacionin për personelin dhe partnerët e angazhuar në programin e ciklit të dytë të studimeve. Në kriterin 2 lidhur me sistemin elektronik, specifikohet se disponohet dokumentacioni i nevojshëm me informacionet mbi stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe për stafin administrativ. Sektori i Burimeve Njerëzore disponon dosjet e të gjithë stafit akademik dhe administrativ që prej aplikimit të tyre[469]. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Që nga viti 2010, UAMD ka implementuar një sistem të menaxhimit të integruar të studentëve. Në kriterin 3 të sistemit elektronik specifikohet se garantohet një akses i plotë në informacione e dokumente të dedikuara. Platforma Pitagora mundëson transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga pedagogu te studenti në konfidencialitet dhe transparencë të plotë[470, 471]. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit | Në kriterin 4 të sistemit elektronik specifikohet sesi arrihet komunikimi interaktiv pedagog-student[472].<br>Shkëmbimi i Informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve realizohet në mënyrë fizike, kryesisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, por edhe me mbështjetjen e platformave elektronike. Sistemi Pitagora është një prej |

[464] Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)
[465] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[466] Evidenca_Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit)
[467] Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik)
[468] Evidenca_Nr.103_(Sistemi Pitagora - RASH)
[469] Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik)
[470] Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik)
[471] Evidenca_Nr.103_(Sistemi Pitagora - RASH)
[472] Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik)

| | |
|---|---|
| ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | sistemeve teknologjike i cili mundëson komunikimin interaktiv ndërmjet studentëve dhe lektorëve. Në këtë platformë, studentët kanë një llogari personale e cila aksesohet tek "zona e studentit". Kjo platformë menaxhohet dhe mirëmbahet nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit që lehtëson komunikimin e drejtpërdrejtë në lidhje me notat, mungesat, kalueshmërinë, kurset e regjistruara, orarin, etj[473]. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Njësia kryesore, Fakulteti i Biznesit, ka ngritur struktura të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Në kriterin 5 të sistemit elektronik specifikohet sesi garantohet monitorimi në kohë reale[474]. Sistemi i menaxhimit të informacionit nuk ekziston i plotë në vetëm në soft, por vetëm në hard-copy. Çdo lektor përpara fillimit të orës mësimore është i detyruar të marrë regjistrin dhe të firmosë listë-prezencën, e cila shërben si element për kontrollin e pranisë së lektorëve gjatë orës së mësimit. Gjithashtu, në përfundim të çdo ore mësimore çdo lektor është i detyruar të dorëzojë në sekretari regjistrin duke përfunduar me sukses orën mësimore dhe duke ju përmbajtur orarit mësimor sipas Nenit 60, 63 dhe 65 të Rregullores së UAMD-së, sipas Nenit 38, 39, 51-54 dhe Neni 56 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[475, 476]. Në raste mungesash, ose mos zhvillimit të orës mësimore për arsye të ndryshme, lektorët janë të detyruar të njoftojnë më shkresë zyrtare përgjegjësin e departamentit dhe t'i përcjellin shkresën Dekanit dhe Zv.Dekanit sipas Nenit 55 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe Nenit 64 të Rregullores së UAMD-së, duke dhënë informacion të detajuar për zëvendësimin e orës mësimore. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik si edhe në lidhje me aktivitete të ndryshme apo njoftime janë të disponueshme në faqen e internetit www.uamd.edu.al në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze[477]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

[473] Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik)
[474] Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik)
[475] Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).
[476] Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)
[477] Evidenca_Nr.108_(Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD)

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Të dhënat mbi kostot e programeve të studimit specifikojnë kostot e programit të studimit të MSH Menaxhim Biznesi duke u mbështetur në numrin e kuotave të studentëve[478]. Të dhënat progresive të UAMD për periudhën Janar 2019-Shkurt 2023 tregojnë realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara në krahasim me ato faktike, ku tregohet qëndrueshmëria financiare e institucionit për mbështjetjen financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit[479]. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Departamenti i Menaxhimit duke qenë njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka hartuar një plan financimi ku specifikohen kërkesat për financim që përfshijnë: shpenzime si materiale për zyrë, shpenzime specifike që përfshijnë literaturën fizike dhe online, aksesin në teknologji, shërbime të ndryshme që financojnë burimet njerëzore si ato për udhëtim, shpenzime të zakonshme për mirëmbajtjen e godinave e mjediseve për mësimdhënie si edhe shpenzime të tjera operative që facilitojnë jo vetëm proçesin mësimor, por edhe aktivitete të ndryshme[480]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Auditi i brendshëm në UAMD kryhet sipas udhëzimit për auditin e brendshëm në përputhje me proçedurat e përcaktuara në Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm.<br>Auditimi i brendshëm në UAMD kryhet në mënyrë të pavarur dhe ofron këshillim për menaxhimin financiar me qëllimin e përmirësimit të veprimtarisë së UAMD-së.<br>Karta e Auditit e UAMD-së miratohet nga Bordi i Administrimit dhe përfshin qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë, përgjegjësitë dhe organizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në UAMD[481]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi | Institucioni garanton transparencën e raportimit të të dhënave progresive pranë njësisë përgjegjëse, Departamenti i Menaxhimit, përgjegjëse për programin e |

[478] Evidenca_Nr.119_(Tabelë me të dhënat financiare mbi koston e Programit MB)
[479] Evidenca_Nr.116_(Të dhëna progresive Janar 2019-Shkurt 2023)
[480] Evidenca_Nr.120_(Projektbuxheti i Departamentit të Menaxhimit)
[481] Evidenca_Nr.118_(Raporti Vjetor i Auditit të Brendshëm për 2018)

| | |
|---|---|
| realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | studimit MSH Menaxhim Biznes për realizmin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës[482]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Raporti i të dhënave progresive tregon qëndrueshmërinë financiare të institucionit për zhvillimin e programit të studimit[483]. Institucioni financiarisht mbështet edhe studentët në nevojë si edhe kërkimin shkencor[484, 485]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, proçesi që nga hyrja deri në daljen e studentëve, në gjithë ciklin e studimit, mbështetet në politika e proçedura, të cilat janë të respektim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit, bazuar në Statutin e UAMD (Neni 57, pika 4; Neni 64; Neni 76)[486], Rregulloren e Fakultetit të Biznesit (Neni 39; Neni 67) [487]; Rregulloren e Master Shkencor Menaxhim Biznesi[488]. |

[482] Evidenca_Nr.116_(Të dhëna progresive Janar 2019-Shkurt 2023)
[483] Evidenca_Nr.116_(Të dhëna progresive Janar 2019-Shkurt 2023)
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Raportet analitike dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësime të mëtejshme të cilësisë. DKSC realizon për çdo vit akademik, Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Raporti hartohet duke u bazuar në 5 fushat e vlerësimit: Organizimi dhe Menaxhimi; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; Studentët dhe mbështetja e tyre.<br>Ky raport përmbledh evidencat me anë të të cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, | Në kuadër të pëmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe Manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Biznesit. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. DKSC përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. DKSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore që do të parashikonte një analizë sistemike të këtyre treguesve. Strukturat e ndryshme të SBSC-së kryejnë mbledhjen e të dhënave, në varësi të llojit të informacionit të kërkuar dhe analiza përcillet në NjBSC. Gjithashtu, lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të dhe dosjet e tyre te vetëvleresimit të cilat i disponojnë të gjithë shefat e departamenteve dhe tek burimet njërëzore. Dosjet e vetëvlerësimit |

| | |
|---|---|
| si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | të lektorëve vlerësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore. Në bazë të formularëve të raporteve çdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik, vlerësimi bëhet në bazë të formatit të vlerësimit i cili kalkulohet nga koordinatori i kërkimit shkencor i cili është përzgjedhur me vendim departamenti. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë ka përfshirja e studentëve në këtë proçes dhe i grupeve të tjera të interesit. Instrumentat e përdorura për metodën e tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në Nenet 6 dhe 16 të Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. NjSBC në çdo rast dokumenton dhe u bën të njohura Senatit Akademik informacionet e përpunuara.<br>Një prej instrumenteve për analizën e arritjeve të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës (TKP), në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD-ja dhe strukturat e saj. Lista e TKP-së realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjSBC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik nga KPSC-ja. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | UAMD ka parashikuar dhe garanton në politikat dhe proçedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit. UAMD i jep prioritet angazhimit të studentëve në çdo nivel të vendimmarrjes. Përfaqësues të studentëve gjejmë në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik e deri tek GVB që ka hartuar këtë Raport të Vlerësimit të Brendshëm. Përfaqësimi i studentëve realizohet edhe në Bordin e Administrimit, NjBSC të fakultetit dhe në formë këshillimore si dhe përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit kur trajtohen çështje të lidhura me ta. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë | Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në Rregulloren për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, veçanërisht në Nenet 9, 10, 11, 12 si dhe në Rregulloren e Fakultetin e Biznesit (Kreu II dhe IV). UAMD përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të |

| | |
|---|---|
| së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së Grupit të punës së Vlerësimit të Brendshëm etj. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit MSH "Menaxhim Biznesi" përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja Fakultetit të Biznesit si dhe Departamentit të Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Respektimi i standardeve akademike dhe integriteti akademik i personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Biznesit dhe UAMD janë parime themelore për këtë institucion. Përzgjedhja e personelit për këtë proçes bazohet në kontributin, seriozitetin dhe integritetin akademik. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proçeset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Konform Ligjit për Arsimin e Lartë, tashmë po përfshihen në proçesin e vlerësimit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, e përmirësimin e saj, edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë. Pjesë aktive e proçeseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë bërë edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit duke dhënë ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për | Nëpërmjet web-it të UAMD, komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimet në rrjetet sociale, studentët informohen peridiokisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të |

| | |
|---|---|
| programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik, si dhe publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë, duke respektuar etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. UAMD në mënyrë periodike realizon takime dhe aktivitete me qëllim njohjen me rezultatet e vlerësimit të programit të studimit. Këto takime kanë formën e diskutimeve dhe bashkëbisedimeve mbi materialet finale të raportit të vetëvlerësimit siç edhe është parashikuar në Rregulloren e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Vlerësimet dhe analizat e realizuara identifikojnë nevojat për përmirësime të metejshme. Në Fakultetin e Biznesit angazhohen dhe marrin masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Në mënyrë periodike, edhe nga analizat, Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti i Biznesit vlerësojnë ecurinë e politikave dhe strategjive të ndjekura deri më tani. Ata marrin masat e nevojshme për ndryshimet eventuale dhe përmirësime të mëtejshme. UAMD vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Në mënyrë periodike, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët. UAMD gjatë këtyre dy viteve të fundit ka ndërmarrë iniciativa të ndryshme me objektiv një llogaridhënie me trasparente dhe efektive. Objektiv kryesor ka qënë jo vetëm transparenca, por edhe pjesëmarrja aktive e grupeve të interesit në politikbërjen dhe sugjerimet e marra në këto organizime. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të vlerësimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave "Menaxhim Biznesi"**

Në përfundim të vlerësimit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për programet e ciklit të dytë të studimit, GVB arrin në përfundimin se programi Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi", i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit, Fakulteti i Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, i plotëson kriteret e cilësisë dhe standardet e një programi bashkëkohor. Për më tepër, do t'i referohemi pikave të forta dhe të dobëta, si më poshtë.

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ai është hartuar dhe zhvillohet në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit.
2. Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me vizionin, misionin dhe planin strategjik të institucionit, fushën e tij të veprimtarisë, si dhe Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së.
3. Programi Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi", garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuar të vetë programit, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe përvojat më të mira bashkëkohore vendase dhe të huaja.
4. Ky program studimi synon arritjen e objektivave të mirëpërcaktuar, të cilët analizohen në mënyrë periodike, me feedback edhe nga vetë studentët.
5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Shkencor "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi.
6. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit, si dhe biznese vendase apo të huaja. Këto marrëdhënie mundësojnë realizimin e objektivave të proçesit mësimor, formues, kërkimor-shkencor dhe të praktikave profesionale.
7. Programi i studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi" është i strukturuar në mënyrë të tillë që të ofrojë njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të biznesit, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës si dhe identifikimi i fushave kërkimore-shkencore. Plani mësimor, syllabuset, metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë hartuar sipas akteve ligjore/nënligjore dhe kërkesave të standardeve më të larta akademike.
8. Programi i studimit është hartuar me shumë kujdes për të plotësuar kërkesat e studentëve dhe mundësuar përputhjen e njohurive dhe aftësive të fituara me ato të kërkuara nga tregu

i punës. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.

9. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demostrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

10. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore shoqërohet me komente/feedback dhe lidhet me këshilla mbi proçesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

11. Zhvillimi i programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi", garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale dhe kërkimore-shkencore.

12. Institucioni i Arsimit të Lartë ndjek proçedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit Master Shkencor "Menaxhim Biznesi". Gjithashtu, institucioni angazhohet, nxit dhe inkurajon kualifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, duke ndikuar pozitivisht në përmbushjen e të gjitha objektivave të këtij programi studimi.

13. Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi", kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mbulimin e moduleve mësimore. Cilësia dhe vitaliteti i personelit akademik, integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor si dhe ndjenja e përmirësimit të vazhdueshëm janë tregues që garantojnë një cilësi të lartë në mësimdhënie dhe përmbushjen e të gjitha objektivave të këtij programi studimi.

14. Bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, krijon mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish etj., por njëkohësisht shërben edhe si nxitës për reflektim dhe përmirësim të mëtejshëm.

15. UAMD, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies, aftësimin profesional dhe kërkimor-shkencor, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike dhe logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

16. UAMD siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën e programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjedisi i përshtatshëm fizik, por edhe intelektual mundëson mësimdhënien konform me kërkesat bashkëkohore.

17. Biblioteka është në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi", përmes literaturës së pasur, fizike dhe online, në fushën e menaxhimit të biznesit, u mundëson studentëve thellimin e njohurive rreth çështjeve të caktuara dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadrin e programit të studimit. Gjithashtu,

Biblioteka u vjen në ndihmë edhe stafit të angazhuar në programin e studimit, për zhvillimin dhe kualifikimin e mëtejshëm në aspektin kërkimor-shkencor dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit.

18. UAMD ka një strukturë të konsoliduar që menaxhon gjithë fluksin e të dhënave të lidhura me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.

19. Kriteret, proçedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga të interesuarit. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e proçesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

20. Mes stafit akademik, administratës dhe studentëve mbizotëron një klimë pozitive e karakterizuar nga fryma e bashkëpunimit. Respektimi i të drejtave të studentëve dhe vendosja e tyre në qendër të politikave dhe strategjive të zhvillimit është filozofia bazë në të cilën mbështetet Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit.

21. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Kjo njësi është struktura përgjegjëse që ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e etj.

22. UAMD dhe njësitë përbërëse të tij kanë krijuar dhe udhëhiqen nga kultura e brendshme e cilësisë, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë pranë çdo Fakulteti. Përmes metodologjisë së vlerësimit, instrumentave matëse dhe vlerësuese, raporteve të vlerësimit me rezultatet e pritshme, rezultatet e arritura dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm, garantohet ecuria dhe mbarëvajtja cilësore e programit të studimit.

**Pika të dobëta**

1. Fakulteti i Biznesit - në tërësi dhe Departamenti i Menaxhimit – në veçanti, pas përvojave të suksesshme akademike, në kuadër të Programeve Erasmus+, ndjejnë nevojën e thellimit të bashkëpunimeve me IAL-të Europiane, përmes ofrimit të diplomave të dyfishta apo shumëfishta. Mungesën e tyre e shohim si pikë të dobët.
2. UAMD ka shpallur si prioritet strategjik ndërkombëtarizimin dhe, në këtë optikë, janë të shumta marrëveshjet për mobilitete, por ende ka një ngurrim dhe dëshirë të vakët për pjesëmarrje nga ana e studenëve tanë.

3. Pjesëmarrje e kufizuar e studentëve të programit të studimit në konferencat studentore dhe projekte kërkimore-shkencore.
4. UAMD është një ndër të paktët universitete në Shqipëri, që ende nuk e ndjen të fortë mungesën e kërkesës studentore për programet e saj të studimit. Për këtë, nuk ka një sens të lartë urgjence në krijimin e një Plani Promocioni të Programeve të Studimit. Kontakti me maturantët fillon të zhvillohet vetëm në periudhën perpara plotësimit të formularëve të "Maturës Shtetërore". Mungesën e kontakteve të vazhdueshme, përmes aktiviteteve dhe kompeticioneve, me shkollat e mesme të qytetit, dhe më gjerë, krijon një hendek preferencial ndërmjet Institucionit dhe qytetarëve. Në këtë kontekst, mungesa e një plani të mirëfilltë marketingu, në tërësi por edhe veçanërisht për programin e studimit Master Shkencor "Menaxhim Biznesi", mund të renditet si një pikë e dobët.
5. Covid 19 e gjeti edhe UAMD të papërgatitur për sfidat e zhvillimit normal të proçeseve akademike. Institucioni, në tërësi, dhe Fakulteti i Biznesit e Departamenti i Menaxhimit në veçanti, nuk kanë "SOP", apo "Plane Emergjence", të detajuar dhe për t'u mbështetur teknologjikisht, bazuar në "mësimet e marra".

**Rekomandime**

1. Intensifikimi dhe formalizimi i përpjekjeve, në nivel Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti, për krijimin dhe ofrimin e një programi të përbashkët studimi Master Shkencor në "Menaxhim Biznesi", në bashkëpunim me IAL-të europiane.
2. Marrëveshjet për mobilitete duhet të tentojnë një numër të shtuar të studentëve dhe të krijohen "platforma komunikimi" të përvojave të studentëve përfitues, për nxitjen e pjesëmarrjes studentore në këto mobilitete.
3. Institucioni duhet të punojë intensivisht dhe me zgjuarsi, në gjetjen e formulave fituese, që rrisin kënaqësinë e jetës studentore, përmes aktivizimit të tyre në "klube tematike" – shkencore, sportive, artistike, kreative, etj. Studentët duhet ta përjetojnë UAMD, si pol reference për zhvillimin e tyre, intelektual dhe humanist.
4. Krijimin e një Plani Marketing të Programeve të studimit dhe kalimin nga statusi "ju mirëpresim", në atë "ne jemi Ju", për shkollat e mesme të qytetit dhe nxënësit e familjet e tyre.
5. Rritja e numrit të projekteve në nivel njësie bazë dhe pjesëmarrje më e madhe e stafit akademik dhe studentëve, përmes këtyre projekteve në zgjidhjet e problematikave të Durrësit. Gjithashtu, rritja e mbështetjes financiare për këto projekte, nga "networku strategjik i dijes", do të afronte dhe ngushtonte hendekun e Institucionit me Durrësin.
6. Krijimi i platformave inteligjente dhe i "planeve të emergjencës", bazuar në "mësimet e marra" nga Covid 19.

## Evaluation's conclusions for the Second Cycle Study Programme Master of Sciences "Business Management"

At the end of the evaluation of the fulfillment of the quality standards for the study programmes of the second cycle, we conclude that the study programme Master of Science in "Business Management", offered by the Management Department, Faculty of Business, University "Aleksandër Moisiu" Durrës, meets the quality criteria and standards of a contemporary programme. Furthermore, we will refer to the strengths and weaknesses as follows.

**Strengths and affirmations**

**1.** The study programme Master of Science "Business Management", aims to preserve and consolidate national academic and cultural values. It is designed and developed in full compliance with national development strategies.

**2.** This study programme is designed and offered in accordance with the vision, mission and strategic plan of the institution, its field of activity, as well as the Statute and Regulation of UAMD.

**3.** The study programme Master of Science "Business Management" guarantees students' preparation in accordance with the programme's own defined objectives, market needs, objectives of the higher education reform in Albania and the best contemporary national and foreign experiences.

**4.** This study programme aims to achieve well-defined objectives, which are analyzed periodically, with feedback also from the students.

**5.** The general and specific field of the study programme Master of Science "Business Management" is in line with the academic and research field of the main unit and basic unit, responsible for providing this study programme.

**6.** University "Aleksandër Moisiu", the Faculty of Business and the Management Department provide co-operation relations with counterparty institutions, both domestically and abroad, as well as local or foreign businesses. These relationships enable the realization of the objectives of the process of teaching, training, scientific research and professional practices.

**7.** The study programme Master of Science in "Business Management" is structured in such a way as to provide valuable knowledge in the field of business management, which includes a critical understanding of theories and academic principles of the field and the identification of research areas. The curriculum, syllabuses, teaching and learning methods are drawn up according to legal acts and the requirements of the highest academic standards.

**8.** The study programme is very carefully designed to meet the requirements of students and to enable the compliance of knowledge and skills acquired with those required by the labor market. The content of the study programme is constantly improved and updated.

**9.** Testing and evaluation of knowledge, professional and scientific skills is realized in different forms and ways, giving student the opportunity to demonstrate the acquired knowledge and competencies.

**10.** The assessment of knowledge, professional and scientific skills and abilities is accompanied by comments/feedback and relates to advice on the learning process in order to help the student to improve in the future.

**11.** The realization of the study programme Master of Science in "Business Management" guarantees the increase of students' creative and implementing skills, while providing extensive knowledge of professional and research-scientific competencies.

**12.** The institution of higher education pursues legal and transparent procedures of recruitment, evaluation and selection of staff for the study programme Master of Science "Business Management". Also, the institution engages, promotes and encourages the qualification and further development of the staff that covers and administers the study programme, positively influencing the fulfillment of all objectives of this study programme.

**13.** Effective and contracted academic staff appointed to the implementation of Master of Science in "Business Management" study programme, have the appropriate level of academic qualification to cover the teaching courses. The quality and vitality of the academic staff, the integration of teaching with scientific research as well as the sense of continuous improvement are indicators that guarantee a high quality in teaching and the fulfillment of all objectives of this study programme.

**14.** Co-operation with institutions of higher education in the country and abroad, creates opportunities for experiential exchange, expertise, information, knowledge, technologies, etc., but also serves as an incentive for reflection and further improvement.

**15.** UAMD, Faculty of Business and Management Department guarantee the development of teaching, learning, professional training and scientific research, by making available all the physical, didactic and logistical infrastructure necessary for the successful implementation of teaching and research-scientific activity.

**16.** UAMD provides sufficient and appropriate teaching facilities for the development of teaching activity, depending on the number of students, teaching groups, in accordance with the nature of the study programme and the relevant modules. The appropriate physical environment, intellectual as well, enables teaching conforming to contemporary requirements.

**17.** The library is available to students of the study programme Master of Science in "Business Management", through rich literature, physical and online, in the field of business management, and enables students to deepen their knowledge about certain issues and to fulfill obligations in the framework of the study programme. The Library also assists the staff engaged in the study programme, for further development and qualification in the scientific-research aspect and to meet the objectives of the study programme.

**18.** UAMD has a consolidated structure that manages the entire influx of data related to the academic staff and students of the study programme.

**19.** Criterias, procedures for admission and selection of students, their progress along the follow-up of the study programme, transfer, recognition of previous studies, assessment of knowledge and graduation are easily understandable and accessible by the interested. Students are provided with updated information on the realization and organization of the teaching process, logistics, infrastructure and services related to the study programme.

**20.** A positive climate, characterized by the spirit of co-operation, prevails between the academic staff, administrative staff and the students. Respecting the rights of students and placing them at the centre of development policies and strategies is the basic philosophy on which the University "Aleksandër Moisiu" Durrës, the Faculty of Business and the Department of Management relies.

**21.** The institution offers students a career counseling service. This unit is the responsible structure for providing assistance in the orientation and development of students' professional careers, maintains contacts with graduates and creates the Alumni Network, creates opportunities for cooperation with companies for internships and employments for students/alumni, organizes activities for students, trainings, seminars, workshops, etc.

**22.** UAMD and its constituent units have created and are led by the culture of quality, through the Internal Quality Assurance Unit and the Commission for the Internal Quality Assessment at each Faculty. Through evaluation methodology, measuring and evaluation instruments, evaluation reports with expected results, achieved results and measures taken to address deficiencies and continuous improvement, quality performance and breeding of the Study Programme is guaranteed.

**Weaknesses**

**1.** The Faculty of Business - as a whole and the Department of Management – in particular, after successful academic experiences, within the Erasmus+ Programmes, feel the need to deepen collaborations with European HEIs, through the provision of dual or multiple degrees. Their absence is seen as a weak point.

**2.** The University "Aleksandër Moisiu" Durrës has declared internationalisation as a strategic priority and, in this optics, there are many mobility agreements, but there is still a vague reluctance and desire for participation on the part of our students.

**3.** Limited participation of the students of the study programme in student conferences and scientific research projects.

**4.** The University "Aleksandër Moisiu" Durrës is one of the few universities in Albania, which still does not feel strong the lack of student demand for its study programmes. For this, there is no high sense of urgency in creating a Promotion Plan of Study Programmes. Contact with high school students begins to develop only in the run-up to the completion of their university applications. The lack of constant contact, through activities and competitions, with the city's high

schools, and more broadly, creates a preferential gap between the Institution and citizens. In this context, the lack of a proper marketing plan, in general and especially for the study programme Master of Science "Business Management" can be listed as a weak point.

**5.** Covid 19 found UAMD unprepared for the challenges of normal development of academic processes. The institution, Business Faculty, and the Department of Management, have no "SOP", or "Emergency Plans", detailed and technologically supported, based on "lessons learned".

**Recommendations**

**1.** Intensification and formalization of efforts, at the University, Faculty and Department level, for the creation and provision of a joint Study Programme Master of Science "Business Management", in co-operation with European HEIs.
**2.** Mobility agreements should attempt an added number of students and create "communication platforms" for the experiences of beneficiary students, to promote student participation in these mobilities.
**3.** The institution must work intensively and intelligently, in finding winning formulas, increasing the enjoyment of student life, through their activation in "thematic clubs" – scientific, sports, artistic, creative, etc. Students must experience UAMD, as a reference pole for their intellectual and humanist development.
**4.** Creation of a Marketing Plan of study programme and the transition from "Welcome" status to that "We are you", for the city's high schools, students and their families.
**5.** Increasing the number of projects at basic unit level and a larger participation of academic staff and students, through these projects in Durres-problems solutions. Also, increasing financial support for these projects, from the "strategic network of knowledge", would confront and bridge the Institution's gap with Durres City.
**6.** Creation of Intelligent Platforms and Emergency Plans, based on "lessons learned" by Covid 19.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

| Nr. | Lista e evidencave mbështetëse<br>Programi i Studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” |
|---|---|
| 1 | Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD) |
| 2 | Evidenca_Nr.2_( Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025) |
| 3 | Evidenca_Nr.2.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020) |
| 4 | Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025) |
| 5 | Evidenca_Nr.3.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020) |
| 6 | Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025) |
| 7 | Evidenca_Nr.4.1_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2017-2021) |
| 8 | Evidenca_Nr.5_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MSH Menaxhim Biznesi) |
| 9 | Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD) |
| 10 | Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit) |
| 11 | Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit) |
| 12 | Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Shkencor Menaxhim Biznesi) |
| 13 | Evidenca_Nr.10_(Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë) |
| 14 | Evidenca_Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit) |
| 15 | Evidenca_Nr.12_(Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit) |
| 16 | Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit) |
| 17 | Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit) |
| 18 | Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit) |
| 19 | Evidenca_Nr.16_(Kodi i Etikës në UAMD) |
| 20 | Evidenca_Nr.17_(Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor) |
| 21 | Evidenca_Nr.18_(Rregullore e Organizimit të Konferencave dhe Veprimtarive Shkencore në UAMD) |
| 22 | Evidenca_Nr.19_(Analiza për Programin e Studimit Master Shkencor Menaxhim Biznesi) |
| 23 | Evidenca_Nr.20_(Korrespondenca për Studimin e Tregut të Punës Përpara Hapjes së Programit të Studimit) |
| 24 | Evidenca_Nr.21_(Urdhëri për Hapjen e Programit të Studimit Viti 2009) |
| 25 | Evidenca_Nr.22_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2020) |
| 26 | Evidenca_Nr.22.1_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MSH Menaxhim Biznesi, 2018) |
| 27 | Evidenca_Nr.23_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2020) |
| 28 | Evidenca_Nr.23.1_(Riorganizimi MSH Menaxhim Biznesi Viti 2018) |
| 29 | Evidenca_Nr.24_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2020 e në vijim) |
| 30 | Evidenca_Nr.24.1_(Plani Mësimor në MSH Menaxhim Biznesi V.A 2018-2020) |
| 31 | Evidenca_Nr.25_(Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore-Shkencore) |
| 32 | Evidenca_Nr.26_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2019-2020) |
| 33 | Evidenca_Nr.27_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2020-2021) |

| | |
|---|---|
| 34 | Evidenca_Nr.28_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2021-2022) |
| 35 | Evidenca_Nr.29_(Syllabuset në Master Shkencor në Menaxhim Biznesi, V.A. 2022-2023) |
| 36 | Evidenca_Nr.30_(Mbështetja financiare nga IAL për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore) |
| 37 | Evidenca_Nr.31_(Urdhër Nr.160, Datë 05.06.2019 Regjistrimi i Formës së Diplomës në MSH Menaxhim Biznes) |
| 38 | Evidenca_Nr.32_(CV e Stafit Akademik në MSH Menaxhim Biznesi) |
| 39 | Evidenca_Nr.33_(CV e Stafit Ndihmës Akademik në MSH Menaxhim Biznesi) |
| 40 | Evidenca_Nr.34_(VKM Nr.75, Datë 12.2.2018, Modeli i Financimit të IAL-ve publike dhe Kërkimit Shkencor) |
| 41 | Evidenca_Nr.34.1_(Udhëzim i përbashkët i MASR dhe MFE Nr.20, Dt.20.9.2019, Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor) |
| 42 | Evidenca_Nr.35_(Analiza vjetore të Departamentit të Menaxhimit) |
| 43 | Evidenca_Nr.36_(Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2022-2024) |
| 44 | Evidenca_Nr.36.1_(Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2019-2021) |
| 45 | Evidenca_Nr.37_(Strategjia 2020-2025 - Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit) |
| 46 | Evidenca_Nr.38_(Anketimi i Studentëve për Vitin Akademik 2020-2021) |
| 47 | Evidenca_Nr.39_(Formulari i Vlerësimit për Pedagogët nga Studentët) |
| 48 | Evidenca_Nr.40_(Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut) |
| 49 | Evidenca_Nr.41_(Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar) |
| 50 | Evidenca_Nr.42_(Strategjia e Kërkimit Shkencor UAMD 2020-2025) |
| 51 | Evidenca_Nr.43_(Fushat e Studimit për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit) |
| 52 | Evidenca_Nr.44_(Shembull praktike MSH në Menaxhim Biznesi) |
| 53 | Evidenca_Nr.45_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit) |
| 54 | Evidenca_Nr.45.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit) |
| 55 | Evidenca_Nr.45.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së) |
| 56 | Evidenca_Nr.45.3_(Lista e Marrëveshjeve për Mobilitete) |
| 57 | Evidenca_Nr.45.4_(Analiza e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit) |
| 58 | Evidenca_Nr.46_(Aktivitete të QKZHE) |
| 59 | Evidenca_Nr.47_(Memo për Kriteret e Pranimit të Studentëve) |
| 60 | Evidenca_Nr.48_(Analiza e tregut të punës MSH Menaxhim Biznes) |
| 61 | Evidenca_Nr.49_(Struktura e Programeve të Studimit në UAMD) |
| 62 | Evidenca_Nr.50_(Praktika mbi Vendimet për Transferim Studimesh) |
| 63 | Evidenca_Nr.51_(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit) |
| 64 | Evidenca_Nr.52_(Të Dhënat për Aktivitetet për Kualifikimin dhe Kërkimin Shkencor për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit) |
| 65 | Evidenca_Nr.53_(Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80, 2015) |
| 66 | Evidenca_Nr.54_(Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, VKM nr. 710, Datë 1.12.2017) |
| 67 | Evidenca_Nr.54.1_(Draft-Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030) |

| | |
|---|---|
| **68** | Evidenca_Nr.55_(Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, VKM Nr.348, Datë 11.05.2016) |
| **69** | Evidenca_Nr.55.1_(Draft-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030) |
| **70** | Evidenca_Nr.56_(Udhëzimi_nr._1_dt._14.01.2020_Hapje dhe Riorganizim Programesh) |
| **71** | Evidenca_Nr.56.1_(Udhëzimi_nr._31_dt._29.12.2017_Hapje dhe Riorganizim Programesh) |
| **72** | Evidenca_Nr.57_(Udhëzimi-nr.-29-dt-10.9.2018_Ngarkesa e Personelit Akademik) |
| **73** | Evidenca_Nr.58_(Tabelë Përmbledhëse me të Dhëna mbi Mobilitete për Mësimdhënie - Trajnim të Stafit Akademik) |
| **74** | Evidenca_Nr.59_(Të dhëna mbi mobilitetet e studentëve në Fakultetin e Biznesit) |
| **75** | Evidenca_Nr.60_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencat e FB) |
| **76** | Evidenca_Nr.61_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencat Studentore) |
| **77** | Evidenca_Nr.62_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2016-2023) |
| **78** | Evidenca_Nr.63_(Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, Viti Akademik 2016-2017) |
| **79** | Evidenca_Nr.64_(Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, Viti Akademik 2017-2018) |
| **80** | Evidenca_Nr.64.1_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit V.A 2021-2022) |
| **81** | Evidenca_Nr.65_(Të Dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MSH Menaxhim Biznes) |
| **82** | Evidenca_Nr.66_(Të Dhëna Tabelore me Ngarkesën e Plotë Mësimore të Stafit Akademik, në të gjitha programet) |
| **83** | Evidenca_Nr.67_(Të Dhëna Tabelore për Numrin e Programeve në Ciklin e I & II që ofron Departamenti i Menaxhimit) |
| **84** | Evidenca_Nr.68_(Të Dhëna të Plota MSH Menaxhim Biznesi për Regjistrimin, Ecurinë, Diplomimin, Nota Mesatare në Hyrje dhe në Dalje v.a. 2017-2023) |
| **85** | Evidenca_Nr.69_(Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Menaxhimit dhe në Fakultetin e Biznesit) |
| **86** | Evidenca_Nr.70_(Marrëveshjet e Bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore) |
| **87** | Evidenca_Nr.71_(Digital Library - Universiteti Aleksandër Moisiu) |
| **88** | Evidenca_Nr.72_(Pjesëmarrja e Lektorëve në Projekte në FB dhe UAMD) |
| **89** | Evidenca_Nr.73_(Model Kontrate Pune - UAMD) |
| **90** | Evidenca_Nr.74_(Programi i Transparencës UAMD) |
| **91** | Evidenca_Nr.75_(Mobilitetet e Stafit të Fakultetit të Biznesit) |
| **92** | Evidenca_Nr.76_(Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Biznesit) |
| **93** | Evidenca_Nr.77_(Njoftime me e-mail Studentët e Masterit) |
| **94** | Evidenca_Nr.78_(Panairi i Punës) |
| **95** | Evidenca_Nr.78.1_(Pyetësori Panairi i Punës 2022) |
| **96** | Evidenca_Nr.79_(Njoftime për punësim të studentëve dhe alumnit) |
| **97** | Evidenca_Nr.80_(Erasmus-Interinstitutional Agreements for mobility for learners and staff) |
| **98** | Evidenca_Nr.81_(Manual Biblioteka Online) |
| **99** | Evidenca_Nr.82_(Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme) |

| | |
|---|---|
| 100 | Evidenca_Nr.83_(Anketimi i studentëve, stafit akademik dhe administrativ) |
| 101 | Evidenca_Nr.83.1_(Anketimi i studentëve Master në FB v.a. 2022-2023) |
| 102 | Evidenca_Nr.84_(Karriera dhe Alumni UAMD, Kalendari i aktiviteteve dhe trajnimet 2021-2023) |
| 103 | Evidenca_Nr.85_(Shoqata Alumni UAMD) |
| 104 | Evidenca_Nr.86_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike) |
| 105 | Evidenca_Nr.87_(Raport mbi Shërbimet e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit) |
| 106 | Evidenca_Nr.88_(Revista Shkencore e UAMD) |
| 107 | Evidenca_Nr.89_(Strategjia e Komunikimit UAMD) |
| 108 | Evidenca_Nr.90_(Përdorimi i Sistemit Elektronik) |
| 109 | Evidenca_Nr.91_(Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, VKM Nr. 621, Datë 22.10.2021) |
| 110 | Evidenca_Nr.92_(Kodifikimi i Programeve në UAMD) |
| 111 | Evidenca_Nr.93_(Proçedura për Pasurimin e Literaturës në Bibliotekë) |
| 112 | Evidenca_Nr.94_(Rregullore për studentët me aftësi të kufizuar) |
| 113 | Evidenca_Nr.95_(Struktura Organizative e UAMD dhe FB) |
| 114 | Evidenca_Nr.96_(Dosja e Programit Master Shkencor Menaxhim Biznesi) |
| 115 | Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura) |
| 116 | Evidenca_Nr.98_(Viti Sabatik për Personelin Akademik) |
| 117 | Evidenca_Nr.99_(Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit) |
| 118 | Evidenca_Nr.100_(Trajnimi i stafit QEV) |
| 119 | Evidenca_Nr.101_(VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 - Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë) |
| 120 | Evidenca_Nr.102_(Kurrikula të ngjashme me MSH Menaxhim Biznesi) |
| 121 | Evidenca_Nr.103_(Sistemi Pitagora - RASH) |
| 122 | Evidenca_Nr.104_(Orari Master Shkencor MB 2018-2023 + CV Stafi Akademik) |
| 123 | Evidenca_Nr.105_(Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë) |
| 124 | Evidenca_Nr.106_(Vendime për Koordinatorët e Programeve) |
| 125 | Evidenca_Nr.107_(Politikat e BNJ, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen) |
| 126 | Evidenca_Nr.107.1_(Proçedura për Rekrutimin e Stafit) |
| 127 | Evidenca_Nr.108_(Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD) |
| 128 | Evidenca_Nr.109_(Mbështetja financiare për studentët) |
| 129 | Evidenca_Nr.110_(Njoftime për studentët) |
| 130 | Evidenca_Nr.111_(Sondazhi Kombëtar i Studentëve_ Takimet informuese dhe udhëzuese 28 Mars 2019, 6 Prill 2022) |
| 131 | Evidenca_Nr.112_(Takime Alumni) |
| 132 | Evidenca_Nr.113_(Përfshirja e Studentëve në Vendimmarrje, Këshillim, Vlerësim) |
| 133 | Evidenca_Nr.114_(Kuotat e Pranimit të Studentëve) |
| 134 | Evidenca_Nr.115_(Raportimi mujor i pagës) |
| 135 | Evidenca_Nr.115.1 (Vërtetim për Kontributet e Sigurimit Shoqëror dhe Shëndetësor) |
| 136 | Evidenca_Nr.116_(Të dhëna progresive Janar 2019-Shkurt 2023) |
| 137 | Evidenca_Nr.117_(Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB) |
| 138 | Evidenca_Nr.118_(Raporti Vjetor i Auditit të Brendshëm për 2018) |
| 139 | Evidenca_Nr.119_(Tabelë me të dhënat financiare mbi koston e Programit MB) |

| | |
|---|---|
| **140** | Evidenca_Nr.120_(Projektbuxheti i Departamentit të Menaxhimit) |
| **141** | Evidenca_Nr.121_(Kalendari i Funksionimit të Bibliotekës në fundjavë) |
| **142** | Evidenca_Nr.122_(Guida e Studentit) |
| **143** | Evidenca_Nr.123_(Projekti CleanScore) |
| **144** | Evidenca_Nr.124_(Studentët dhe Kërkimi Shkencor) |
| **145** | Evidenca_Nr.125_(Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Master Shkencor "Menaxhim Biznesi) |